

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

28/05/2019

Për: **LALA'SHPK**, NIPT: **J76418903B**, Adresa: **Krume, Has.**

Procedura e prokurimit: **Kerkesë për Propozim-Punë, rruge elektronike;**

Numri i referencës së procedurës/lotit: **REF-19969-04-27-2019**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **"Shpenzime Mirembajtje Rruge Rurale, Kanalizime"**
(Rikonstruksion i Rrugeve Rurale Bashkia Has)

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): **Buletini i Njoftimeve Publike, Datë 06/05/2019, Nr.18**

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: **çmimi më i ulët** ☒

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. **"2R-Group" SHPK** NIPT: **L57104903Q**

Vlera: **5,833,100.0** (Pesëmilion e Tetëqind e tridhjetë e tremijë e njëqind)lekë pa tvsh.

2. **"LALA" SHPK**, NIPT: **J76418903B**,

Vlera: **6,009,643.0** (Gjashtëmilion e nëntë mijë e gjashtëqind e dyzet e tre) lekë pa tvsh

3. **"SARK" SHPK**, NIPT: **K52531415H**

Vlera: **4,975,980.0** (Katërmilion e nëntëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë) lekë pa tvsh

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. **"2R-Group" SHPK** NIPT: **L57104903Q**

2. **"SARK" SHPK** NIPT: **K52531415H**

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

"2R-Group" SHPK NIPT: L57104903Q

Operatori Juaj Ekonomik Skualifikohet Sepse :

Në skedarin me emërtimin [Vertetim OSHEE](#), Vertetim debie për operatorët ekonomikë për pjesmarje në procedurat e prokurimit publik,", me Nr.63 Prot., datë 10/05/2019, lëshuar nga OSHEE, për llogari të Operatorit 2R-GROUP" Shpk, rrezulton të ketë detyrime në total: 495,315.14 lekë, "....e cila likujdohet rregullisht çdo muaj sipas akt-marrveshjes aktive....."

Në zbatim të VKM Nr.914, datë datë 29.12.2014 **"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"**(i ndryshuar), Neni 26(Kontratat për punë publike), pika 7 (Për të provuar përmbushjen e kriterit për kapacitetet financiare dhe ekonomike, autoriteti kontraktor kërkon: c) një vërtetim

që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri. Mosshlyerja e detyrimeve të energjisë elektrike përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik, përveç rastit kur rezulton se detyrimet e papaguara të energjisë elektrike, të konfirmuara në vërtetimin e lëshuar nga furnizuesi, janë në proces ankimi në gjykatë. Furnizuesi i energjisë elektrike është i detyruar që ta lëshojë këtë vërtetim jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e depozitimit të kërkesës nga operatori ekonomik.

Për sa më sipër jeni në kushtet e mosplotësimit të kriterëve të DST, moszbatim të VKM Nr.914, datë datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”(i ndryshuar),

Operatori Juaj Ekonomik “2R-Group” Shpk ndër të tjera ka bashkëngjitur skedarin me emertimin [Ekstrakt Historik](#), nga ku është hapur adresë dytësore në: "Durrës; DURRES; Durrës; DURRES; Rruga Durrës-Tiranë, Kilometri 5, Zona Kadastrale Nr.3852, Nr.Pasurisë 298/55, Sheshi i Scholz".

Nuk plotësoni një nga kriteret e DST, Kriteret e Veçanta, Kapaciteti ekonomik dhe financiar, pika 3 ku kërkohej që: "3. Vërtetim të lëshuar nga autoritetet locale (ku operatori ka seline dhe aktivitetin sipas QKB) për shlyerjen e detyrimeve (taksave-trarifave) vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2016, 2017 dhe 2018, në vendet ku ka ushtruar aktivitet (sipas Ekstraktit). Në rastin e bashkimit të operatoreve çdo operator duhet të dorëzojë këtë vërtetim dhe sipas vendodhjes".

Për sa më sipër nuk keni arritur për paraqitni vërtetimin e kërkuar për shlyerjen e detyrimeve vendore për adresën dytësore.

“SARK” SHPK, skualifikohet për arsyet që vijojnë:

Operatori Juaj Ekonomik, në skedarin me emertimin [Vertetim xhiro 2016-2017-2018 08.05.2019](#), ka paraqitur vërtetimin me nënshkrim elektronik i cili ka përmbajtjen dhe destinacionin për një objekt tjetër prokurimi, AK tjetër, datë tjetër tenderimi, vendodhje tjetër prokurimi, Citojmë: “Ky vërtetim lëshohet për pjesëmarrjen në tenderin që zhvillohet në datën 2019-05-10, sipas ftesës së bërë nga enti prokurues (institucioni): Bashkia Gjirokastrë, me objekt prokurimi: Sinjalistike rrugore, me vlerë: 5164114 Lekë, me vendndodhje në Gjirokastrë”(çfarë nuk janë plotësuar kërkesa të DST, Kriteret e veçanta të kualifikimit, pika 2.2 kapacitetin ekonomik dhe financiar).

Në paragrafin e fundit të Shtojcës 11, kërkohej: Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Operatori Juaj Ekonomik, ka paraqitur skedarin me emërtimin: Ing R.Tabaku kontrate +licenc+cv+librez pune (3), nga ku vërehet që mungon kontrata noteriale mes OE “SARK” Shpk dhe Ing.Ndertimit Rozina Tabaku. Është paraqitur një kontratë e lidhur me operatorin dhe Ing.Rozina Tabaku, nga ku fotokopja e kësaj kontrate jo noteriale është noterizuar për tu vërtetuar njësisht me origjinalin. Për Ing.Rozina Tabaku në listë pagesën e kompanisë për muajin Janar 2019, Shkurt 2019 dhe Mars 2019, figuron me pagesë 26,000 lekë, ndërkohë që në kontratën e nënshkruar (jo noteriale) me kompaninë dhe Ing.Rozina Tabaku, në pikën 3 thuhet që pagesa do bëhet 1(një) herë në muaj dhe masa do jetë 50,000 lekë në muaj. Gjithashtu në CV e Ing. Rozina Tabaku, Eksperienca në punë, është thënë që në periudhën Maj 2014-Korrik 2018 ka mbajtur pozicionin “Drejtor e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit Territorit”, Bashkia Peqin. Sipas librezës së Punës(fotokopje e panoterizuar) së Ing.Rozina

Tabaku, figuron që të jetë larguar nga bashkia Peqin me datë **30/09/2018**, ndërkohë që fillimin e punës pranë kompanisë “SARK” Shpk e ka me datë **05/07/2018**. Nga ku shihet fakti i mbivendosjes së punësimit njëkohësisht dhe me kohë të plotë në bashkinë Peqin. Fakti konfirmohet nga vertetimi me nënshkrim elektronik, me Nr.T01052083, Datë, 09.05.2019, “Për Kontributet e Sigurimeve Shoqërore e Shëndetësore për Individin - E-SIG 03/a”, të siguruar nga AK Bashkia Has, me page bruto mujore prej 59,880 (Pesëdhjetë e nëntëmijë e tetëqind e tetëdhjetë) lekë.

Në DST, Kriteret e vecanta të kualifikimit, paragrafi i fundit thuhet shprehimisht që: Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Operatori Juaj Ekonomik, ka paraqitur skedarin me emërtimin: Mjeti AA460DN DOKUMENTACION (1) kamion 16 ton, nga verifikimi dokumentacionit mjetit **shihet që i ka mbaruar vlefshmeria e Polices Sigurimit(Siguracionit) me datë 07/05/2019, ndërkohë që data e tenderimit ishte me 13/05/2019,** kërkesë e DST, Kriete të veçanta të kualifikimit, pika 2.6, Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund të vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojitet për ekzekutimin e kontratës, germa **b, kërkohej:** *Per mjetet qe shenohen ne regjistra publike duhet te paraqitet dokumenti qe verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit, dhe per mjetet e siguruar me qera, dokumenti qe verteton regjistrimin e tij plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit, duhet te shoqerohet me kontraten perkatese te qerases/furnizimit, e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates object i ketij prokurimi.*

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë: Operatorin **LALA'SHPK, Adresa: Krume, Has**, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej: **6,009,643.0 (Gjashtëmilion e nëntëmijë e gjashtëqind e dyzet e tre) lekë pa tvsh**, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë **Bashkia Has, Sheshi “Dëshmorët e Hasit”, qyteti Krumë**, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda **5(pesë)** ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues **(Nuk ka)** në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej *[vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]*, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë: **21/05/2019**

Ankesa: nuk **ka**

Adem LALA

Titullari i autoritetit kontraktor